



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština -Municipality of Prishtina

---

**R R E G U L L O R E**  
**P Ë R**  
**DHËNIEN E BANESAVE TË KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**NË SHFRYTËZIM ME QIRA PËR ANËTARËT E FAMILJEVE TË DËSHMORËVE,**  
**INVALIDËVE DHE VETERANËVE TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS**

Prishtinë, 2011

Në bazë të dispozitave të nenit 5, pika 5. 1, shkronja **b**, nenit 11, nenit 12, pika 12. 2, shkronja **c**, nenit 14, pika 14. 2 dhe dispozitave të nenit 17, pika 17. 1, shkronja **k** të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), të dispozitave të Udhëzimeve administrative nr. 21/2010, për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit, nr. 22/2010, për procedurat e përfitimit nga programet e veçanta të banimit dhe nr. 23/2010, për procedurat e shpalljes së programeve të veçanta të banimit të ministrit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, të dispozitave të nenit 33, pika 33.1, shkronja **a** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25. 2. 2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 29.9.2011, miratoi këtë

## **R R E G U L L O R E**

### **PËR**

### **DHËNIEN E BANESAVE TË KOMUNËS SË PRISHTINËS NË SHFRYTËZIM ME QIRA PËR ANËTARËT E FAMILJEVE TË DËSHMORËVE, INVALIDËVE DHE VETERANËVE TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS**

#### **I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

##### **Qëllimi**

##### **Neni 1**

Me këtë Rregullore përcaktohen kushtet, kriteret dhe procedurat e dhënies me qira të banesave në pronësi të Komunës së Prishtinës, për anëtarët e familjeve të dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

##### **Neni 2**

2.1 Komuna e Prishtinës, si person juridik, posedon pasuri të paluajtshme dhe objekte banimi, individuale dhe kolektive, të destinuar për zgjidhjen e çështjes së strehimit të individëve dhe familjeve në nevojë dhe të menaxhojë me atë pasuri.

2.2 Komuna si e tillë, mund të investojë në ndërtimin e banesave për kategoritë e caktuara, qoftë me mjete vetanake, mjete të Qeverisë së Kosovës, të jetë bashkëinvestuese me partneritet publiko-privat, apo mund ta realizojë ndërtimin e tyre me forma të tjera, si: përmes ndihmave financiare apo donacioneve për ndërtim të objekteve të banimit të karakterit social, individual apo kolektiv, nga subjektet tjera fizike, juridike, shoqatat e ndryshme humanitare, brenda territorit të komunës dhe jashtë komunës, apo edhe jashtë vendit, të cilat shprehin vullnetin për investime me destinim për rastet në nevojë.

##### **Neni 3**

Banesat e destinuar për strehimin e rasteve në nevojë, me vendim të Komunës, ndahen sipas kriterëve, kushteve dhe procedurës së përcaktuar me këtë rregullore.

#### **II. KUSHTET E DHËNIES SË BANESËS SË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM**

##### **Neni 4**

4.1 Banesat e parapara për strehimin e individëve apo familjeve në nevojë, jepen në shfrytëzim me qira për kohë të caktuar deri në 10 vjet, me mundësi vazhdimi.

4.2 Pas dhënies së banesës në shfrytëzim me qira, lidhet kontrata mbi qiranë në mes të qiradhënësit – Komunës së Prishtinës, të cilën e përfaqëson kryetari i Komunës së Prishtinës, dhe përfituesit të banesës për shfrytëzim me qira. Në kontratë përcaktohen kushtet e dhënies me qira, mënyra e shfrytëzimit, qiraja, të drejtat dhe mundësia e shkëputjes së kontratës.

#### **Neni 5**

Të drejtë aplikimi për marrjen me qira të banesës së Komuna së Prishtinës, ka individi ose familja e antarit të UÇK-së, të cilët në kohën e aplikimit është/janë banorë të komunës së Prishtinës.

#### **Neni 6**

6.1 Përfituesi i së drejtës së shfrytëzimit të banesës, nuk mund ta fitojë të drejtën e pronësisë në objektin e banimit dhe nuk ka të drejtë ta tjetërsojë atë te personi i tretë.

6.2 Përfituesi i së drejtës së shfrytëzimit të banesës e humb të drejtën në shfrytëzim me qira të objektit, në rast se:

- a) nuk banon në të, pa arsye, në periudhën deri në gjashtë muaj;
- b) nuk e paguan qiranë mujore për 6 muaj rresht;
- c) objektin në shfrytëzim ia jep personit të tretë;
- d) vdes shfrytëzuesi individual i banesës dhe
- e) përfaqësuesi i kryetarit të Komunës konstaton se nuk i takon kategorisë për të cilën i është dhënë banesa.

6.2 Në rastet e përmendura në pikën 2 të këtij neni, qiradhënësi – Komuna e Prishtinës, merr vendim për marrjen e banesës, duke e obliguar shfrytëzuesin që ta lirojë atë brenda afatit prej 30 ditësh.

### **III. KRITERET BAZË PËR DHËNIEN E BANESËS SË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM**

#### **Neni 7**

Kriteret bazë që duhet të plotësohen për të aplikuar për të drejtën e shfrytëzimit të banesës me qira, për familjet e dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të UÇK-së janë si në vijim.

Aplikuesi duhet:

- a) të jetë shtetas i Republikës së Kosovës, duke dëshmuar këtë me certifikatën e shtetësisë;
- b) të jetë banor i komunës së Prishtinës, së paku 10 vjet para kohës së aplikimit, duke dëshmuar këtë me letërnjoftim, të lëshuar nga organet përkatëse në Prishtinë;
- c) të mos ketë banesë apo shtëpi në pronësi individuale në komunën e Prishtinës apo në komunat tjera në Kosovë;

- d) të mos ketë patundshmëri – tokë në komunën e Prishtinës apo në komunat e tjera në Kosovë;
- e) të dëshmojë se është anëtar i familjes së dëshmorit, pjesëtar i UÇK-së, që ka rënë në luftë për lirinë e vendit në vitet 1998 - 1999;
- f) të jetë invalid, me dëmtim trupor së paku 10%, në periudhën nga formimi i UÇK-së e deri më 20.6.1999 dhe
- g) të jetë veteran kandidati i cili është regjistruar si ushtar nga Komanda – shtabet e zonave operative të UÇK-së, brenda periudhës 30.12.1991 - 30.6.1999.

### **Neni 8**

Varësisht nga numri i anëtarëve të familjes dhe nga fondi i banesave të Komunës për dhënie në shfrytëzim, banesa mund t'i jepet në shfrytëzim:

- a) personit të vetëm, çiftit të vetëm ..... 1 - dhomëshe,
- b) personit me 3 - 5 anëtarë të familjes ..... 2 - dhomëshe,
- c) personit me mbi 5 anëtarë të familjes ..... 3 - dhomëshe,

### **Neni 9**

9.1 Kriteret për vlerësim me pikë të aplikuesve për ndarjen e banesave, janë si në vijim:

- a) statusi i banimit,
- b) lartësia e të ardhurave,
- c) gjendja shëndetësore,
- d) invaliditeti dhe
- e) struktura e familjes.

9.2 Kriteret sipas radhës së përparësisë, nga shkronja **a** deri te shkronja **e**, janë:

N r.	TABELA E VLERËSIMIT SIPAS KRITERËVE TË PËRPARËSISË			Pikët
I	STATUSI I BANIMIT	1.1	Individi / familjet që jetojnë në objekte të rrezikshme ose të papërshtatshme për banim	10
		1.2	Individi / familjet që jetojnë në objekte që janë nën normat minimale të banimit	8
		1.3	Individi / familjet që jetojnë në objekte të huaja	6
		1.4	Individi / familjet që jetojnë me qira të tregut për më shumë se 5 vjet	4
II	LARTËSIA E ARDHURAVE TË	2.1	Individi / familjet me të ardhura mbi kufirin minimal deri në 150 €	10
		2.2	Individi / familjet me të ardhura nga 150-250 €	8
		2.3	Individi / familjet me të ardhura nga 250-300 €	6
		2.4	Individi / familjet nën kufirin minimal të të ardhurave të përcaktuara sipas nenit 6, të Ligjit, që subvencionohen nga Komuna	10
III	GJENDJA SHËNDETSORE	3.1	Individi / familjet me përkujdesje të personave.	8
		3.2	Sëmundje të rënda kronike konsiderohen: sëmundjet malinje, sëmundjet e rënda të gjakut, diabeti tek rastet e rënda me insulinë sëmundjet e ndryshme kroniket, veshkave në dializë dhe pas transplantove të veshkës, forma të rënda të astmës, sëmundjet kronike të papërcaktuara të mushkërive, tuberkulozi, skleroza, sëmundjet e sistemit imunitar, format e rënda të çrregullimeve të metabolizmit, epilepsia, sëmundjet tjera të rënda të zemrës dhe neuroza.	6
I V	KRITER PËR INVALIDITETI	4.1	Invalid me mbi 80% të dëmtimit trupor, të cilëve për jetë normale u nevojitet përkujdesja dhe ndihma e një personi tjetër	10
		4.2	Invalid me 71 % deri 80 % të dëmtimit trupor.	9
		4.3	Invalid me 61 % deri 70 % të dëmtimit trupor	8
		4.4	Invalid me 51 % deri 60 % të dëmtimit trupor	7
		4.5	Invalidë me 41 % deri 50 % të dëmtimit trupor	6
		4.6	Invalidë me 31 % deri 40 % të dëmtimit trupor	5
		4.7	Invalidë me 21 % deri 30 % të dëmtimit trupor	4
		4.8	Invalid me 10 % deri 20 % të dëmtimit trupor	3
V	STRUKTURA E FAMILJES	5.1	Të moshës 0-5 vjeç, që kanë nevojë për përkujdesje të plotë	8
		5.2	Ndërmjet moshës 6-18 vjeç, që janë në shkollim	6
		5.3	Ndërmjet moshës 18-25 vjeç, që janë në shkollim	4
		5.4	Të moshës mbi 65 vjeç	3

## **IV. PROCEDURA PËR DHËNIEN E BANESËS SË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM**

### **Neni 10**

10.1 Për dhënie e banesës në shfrytëzim me qira, Komuna e Prishtinës formon *Komisionin për çështje banesore* (në tekstin e mëtejme "Komisioni"). Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët caktohen nga Kryetari i Komunës. Komisioni duhet të ketë së paku një anëtar nga Shoqatat e dala nga lufta.

10.2 Komisioni caktohet nga Kryetari i Komunës, për secilin rast në veçanti.

10.3 Anëtarët e Komisionit nuk mund të jenë aplikues për marrjen e banesës në shfrytëzim me qira.

### **Neni 11**

11.1 Komisioni përpilon dhe publikon shpalljen – konkursin për dhënie e banesave me qira nga fondi i banesave që ka në dispozicion Komuna.

11.2 Shpallja – konkursi për dhënie e banesave në shfrytëzim me qira publikohet në ueb - faqen e Komunës, në tabelën e shpalljeve publike të Komunës, në vende publike – objektet institucionale, si dhe në ndonjërin nga gazetatat e përditshme, në mënyrë që të gjithë të interesuarit të kenë mundësi aplikimi.

11.3 Afati për aplikim është 30 ditë nga dita e publikimit të shpalljes – konkursit.

### **Neni 12**

12.1 Komisioni përpilon pyetësorin – kërkesën sipas shtojcës nr. 1 të Udhëzimit administrativ nr. 23/2010, për procedurat e shpalljes së programeve të veçanta të banimit, i cili do t'iu jepet aplikuesve për plotësim dhe dorëzim, me të dhënat dhe dëshmitë e kërkuara.

12.2 Kërkesa – aplikacioni merret dhe dorëzohet në Zyrën e pranimi në Komunën e Prishtinës.

12.3 Aplikacionet duhet të paraqiten në afatin e caktuar për aplikim, të përcaktuar me shpallje – konkurs.

### **Neni 13**

13.1 Aplikuesi duhet t'i bashkëngjisë kërkesës këto dokumente:

- a) Proven se është banor i komunës së Prishtinës;
- b) Vërtetimin se nuk ka pasuri të paluajtshme – banesë, shtëpi apo tokë në pronësi të tij, në komunën e Prishtinës apo jashtë komunës së Prishtinës;
- c) Certifikatën e lindjes për secilin anëtar të familjes dhe
- d) Vërtetimin mbi të ardhurat personale të tij dhe të anëtarëve të familjes.

13.2 Dokumentet e kërkuara nuk mund të jenë më të vjetra se 6 (gjashtë) muaj nga dita e lëshimit të tyre.

13.3 Kërkesës i bashkëngjiten edhe dëshmi të tjera, të cekura në nenin 12 të kësaj rregulloreje.

13.4 Komisioni i evidencon kërkesat për dhënien e banesave në shfrytëzim me qira, të cilat dorëzohen përmes Zyrës së pranimit.

13.5 Kërkesat e rregullta merren në shqyrtim dhe caktohet numri i pikëve, sipas kritereve të parapara në shtojcën nr. 1 të Udhëzimit administrativ 23/2010.

13.6 Komisioni në terren bënë vlerësimin e gjendjes së banimit të individëve dhe familjeve, brenda 30 ditëve nga mbyllja e konkursit.

#### **Neni 14**

14.1 Në bazë të numrit të pikëve të fituara, Komisioni harton listën e aplikuesve, duke i radhitur në bazë të pikëve.

14.2 Përparësi për dhënien e banesës në shfrytëzim do ta ketë aplikuesi, i cili ka numër më të madh të pikëve.

14.3 Caktimi i pikëve sipas kërkesës, bëhet në bazë të dokumentacionit të dorëzuar brenda afatit të paraparë.

#### **Neni 15**

15.1 Pas përcaktimit të pikëve dhe hartimit të listës së aplikuesve, sipas pikëve të fituara, Komisioni e publikon listën në tabelën e shpalljeve të Komunës dhe në ueb-faqen e Komunës, në mënyrë që aplikuesit të njoftohen me rezultatin e vlerësimit të Komisionit dhe të kenë mundësinë për të paraqitur kërkesë për rishqyrtimin e listes.

15.2 Aplikuesit mund t'i paraqesin kërkesën për rishqyrtim me shkrim, në afat prej 30 ditësh nga dita e publikimit të listës, Komisionit për zgjidhjen e çështjes së banimit.

15.3 Pas shqyrtimit të kërkesave për rishqyrtim, lista përfundimtare i dërgohet Kuvendit të Komunës për miratim .

15.4 Pala e pakënaqur ka të drejtë të kundërshtojë Vendimin e Kuvendit në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

#### **Neni 16**

Në bazë të Vendimit të Kuvendit, lidhet kontrata për qiranë në mes të kontraktuesit - Komunës së Prishtinës, të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës dhe përfituesit të banesës si qiramarrës.

### **V. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 17**

Dispozitat e kësaj rregulloreje do të zbatohen në të gjitha rastet e dhënies së banesës në shfrytëzim me qira nga fondi banesave të Komunës së Prishtinës për dëshmorë, invalidë, veteranë, pjesëtar të UÇK - së, dhe familjet e tyre.

**Neni 18**

Kjo rregullore hynë në fuqi 8 ditë nga dita e publikimit të saj në tabelën e shpalljeve të Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**

**01. nr.360-2803 , më 06.12.2011**

**KRYESUESI I KUVENDIT  
Sami Hamiti, ecc. i dipl.**